

AZETA



ZYRTARE

Ë Premte, 27 Dhjetor 1946

Nr 117

T O H E T P R E J K R Y E M I N I S T R I S Ë

Taksat e Gazetës Zyrtare:

M:	per nji vit	Fr. 24
	per 6 muaj	" 12
R:	per çdo numur të ri	0,20
	" " " të vjetër	0,40

SHPALLJE:	Taksë minimale	fr. 8
	per çdo shtyllë	" 10

Pajtimet dhe shpalljet e vogla parapagueshen. Të hollat derdhen n' Arkat Financiare të Shtetit dhe dëftesa i dërgohet Gazetës Zyrtare për vërtetimin e pagesës.

P È R M B A J T J E

E datë 16 Dhjetor 1946, Nr. 377	
Shtetësinë Shqiptare	f. 1
Ekz. Devoll — Vendime sekuestrimi	" 4
ije Gjyqesh	" 8

L A J M È R I M

erohen Dikasterët, Zyrat dhe Entet si edhe Komitetet Ekzekutivë të Kë-pulllore se, duke filluar nga viti i ri të paguajnë pajtim për të marrë rtare.

aj, duhet të njoftojnë sa më parë sa-ve që do të marrin si t'abonuarë, ndërpritet dërgimi i Gazetës. Pajtimi uidohet më von.

at do derdhen në Arkën e Shtetit lege të Bankës së Shtetit Shqiptar përkatëse do t'i dërgohet kësaj së për Gazetën Zyrtare.

që dëshirojnë të vazhdojnë aboni-e ri duhet të derdhin menjherë timit. Nuk do t'u dërgohet asnjë vërtetuar pagesa.

NGA ADMINISTRATA

D E K R E T

Nr. 252 datë 16 Dhjetor 1946

Presidiumi i Kuvendit Popullor

Në mbështetje të art. 54 Nr. 5 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipëris,

Passi u votua nga Kuvendi Popullor

S h p a l l i:

Ligjën Nr. 377 datë 16 12-1946 mi shtetësinë shqiptare, me titull e përmbajtje si vijon:

Ligjë nr. 377 datë 16 12 1946 mi shtetësinë shqiptare.

Kaptina e I të

Dispozita të përgjithëshme

Neni 1.

Shtetësija në Republikën Popullore të Shqipërisë rregullohet sipas ligjeve të brëndëshme dhe traktateve ndërkombëtare.

Neni 2.

Kushdo që ka shtetësinë shqiptare nuk munt të ketë në njëkohë dhe shtetësinë e një shteti tjetër.

Kaptina e II të

Fitimi i shtetësisë

Neni 3.

Shtetësija shqiptare fitohet:

a) me origjinë;

b) me lindje në Shqipëri;

c) me naturalizim;

c) sipas dispozitave të traktateve ndërkombëtare.

Neni 4.

A. Origjina.

Fitojnë shtetësinë shqiptare me origjinë fëmijt.

1. Kur të dy prindët janë shtetas shqiptarë,

2. Kur njëri nga prindët është shtetas shqiptar dhe fëmija ka lindur nga një martesë legale të lidhur regullisht përpara organeve kompetente shqiptare;

3) Kur njëri nga prindët është shtetas shqiptar dhe bashkë me fëmijën banon për gjithnjë në Shqipëri, ose vendoset bashkë me fëmijën në Shqipëri, përpara se fëmija të mbushi moshën 18 vjeç, ose fëmija vetë vendoset në Shqipëri përgjithënjë ose për të ndjekur studimet;

4. Kur njëri nga prindët është shtetas shqiptar, por fëmija ka lindur dhe rron bashkë me prindët jashtë shtetit, në rast se prindi që ka shtetësinë shqiptare e regjistron fëmijën si shtetas shqiptar pranë përfaqësisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, brënda 5 vjetëve nga dita e lindjes së tij. Në rast se fëmija, në bazë të ligjës së vendit ku ka lindur konsiderohet shtetas shqiptar, regjistrimi i tij pranë përfaqësisë shqiptare nuk është një konditë e domosdoshme për fitimin e shtetësisë shqiptare.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për të miturit që kanë lindur prej një shtetase të huaj, kur provohet ma vonë atësija e shtetasit shqiptar.

Neni 5.

B. Lindja në Shqipëri

Kur një fëmijë ka lindur ose është gjetur në Shqipëri dhe prindët e tij nuk njihen, konsiderohet si shtetas shqiptar në rast se nuk njihen prindët e tij përpara se të plotësojë moshën 14 vjeç.

Dispozita e këtij neni zbatohet edhe për fëmijë që kanë lindur në Shqipëri nga prindër pa shtetësi ose me shtetësi të panjohur.

Neni 6.

C. Naturalizimi

Shtetasit e huaj munt të fitojnë shtetësinë shqiptare me rrugë të zakonëshme ose të jashtëzakonëshme.

Në çdo rast shtetësija jepet me vendim të Ministrisë së P. të Brëndëshme.

Neni 7.

Shtetësija e huaj munt të fitojnë shtetësinë shqiptare me rrugë të zakonshme në qoftë se përmbushin këto kondita:

- 1) Të kenë paraqitur lutje për naturalizim;
- 2) Të kenë mbushur 18 vjeç dhe të jenë të zotë për punë;
- 3) Të kenë banuar vazhdimisht të paktën 5 vjet në Shqipëri përpara paraqitjes së lutjes;
- 4) të kenë lejë për të lënë shtetësinë e tyre të mëparëshme ose të provojnë që shteti i tyre nuk pengon që të marrin shtetësinë shqiptare;
- 5) Të kenë sjellje që tregojnë se do të jenë shtetas besnikë të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Kur një person nuk ka shtetësi, ose kur, sipas ligjës së vendit të tij, fitimi i një shtetësije të huaj do të kishte si pasojë humbjen e shtetësisë së mëparëshme, kondita 4 e këtij neni quhet si e plotësuar. Në qoftë se një shtet i huaj nuk lejon shtetasit e tij që të fitojnë shtetësi tjetër ose vë kondita që nuk munt të plotësohen, në këtë rast mjafton që shtetasi i huaj që kërkon të fitojë shtetësinë shqiptare të deklarojë në mënyrë të shprehur se do të heq dorë nga shtetësija e tij e mëparëshme.

Kur një person është i kombësisë shqiptare munt të fitojë shtetësinë shqiptare edhe pa pasur konditat e numurit 3 e 4.

Neni 8.

Kur një person ka lidhur martesë me një shtetas ose me një shtetase shqiptare, shkarkohet nga detyrimi që të përmbushi konditat e numurit 2,3 dhe 4 të nenit 7 të kësaj ligje.

Gjithashtu shtetasi shqiptar që ka adoptuar një fëmijë të huaj nën 14 vjeç munt të kërkojë naturalizimin e kësaj fëmije pa qënë i detyruar të përmbushi konditat e nenit 7 numuri 2,3 dhe 4.

Neni 9.

Shtetësija shqiptare munt të fitohet me rrugë të jashtëzakonëshme prej një personi naturalizimi i të cilit paraqit një interesë të veçantë për shtetin.

Në këtë rast shtetasi i huaj duhet të plotësojë vetëm konditat e parashikuara prej numurit 1 e 2 të nenit 7 të kësaj ligje.

Neni 10.

Personi që fiton shtetësinë shqiptare me naturalizim duhet të bëjë betimin e besnikërisë dhe të respektimit të ligjeve.

Vetëm pas kryerjes së betimit personi i përmëndur më lart bëhet shtetas shqiptar.

Në rast se betimi nuk bëhet brënda 3 muajve nga data e komunikimit të vendimit të naturalizimit, ky vendim nuk ka asnjë efekt.

Neni 11.

Me naturalizimin e të dy prindëve fitojnë shtetësinë shqiptare edhe fëmijët e tyre nënë moshën 18 vjeç.

Kur vetëm njëri nga prindët ka fituar me naturalizim shtetësinë shqiptare, fëmijët fitojnë këtë shtetësi në rast se kjo kërkohet shprehimisht dhe fëmijët banojnë në Shqipëri bashkë me prindët e naturalizuar. Në qoftë se fëmijët kanë mbushur moshën 14 vjeç duhet dhe pëlqimi i tyre.

Kapitla e III të

Humbja e shtetësisë

Neni 12.

Shtetasit shqiptarë humbasin shtetësinë e tyre:

- a) kur mungojnë nga Shqipëria (absençë);
- b) kur u është hequr shtetësija shqiptare;
- c) kur janë lejuar të lënë shtetësinë shqiptare;
- c) kur kanë renoncuar nga shtetësija shqiptare;
- d) sipas dispozitave të traktateve ndërkombëtare.

Neni 13.

A. Absenca

Humbet shtetësinë shqiptare shtetasi që banon vazhdimisht jashtë Shqipërisë në rast se brënda 15 vjetëve nga dita që ka mbushur 18 vjeç nuk ka përmbushur asnjë detyrë publike kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë dhe në 5 vjetët e fundit nuk është paraqitur në përfaqësinë shqiptare ose nuk ka lajmëruar Ministrinë e Punëve të Brëndëshme mbi gjëndjen e tij.

Humbja e shtetësisë për shkak absence shtriet edhe mi fëmijët që kanë lindur dhe banojnë azhdimisht jashtë shtetit përveç kur kanë plotësuar konditat e parashikuara prej paragrafit të parë të këtij neni.

Vendimin e humbjes së shtetësisë e jep Ministrija e Punëve të Brëndëshme. Vendimi munt kundërshtohet brenda dy vjetëve që nga data shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare.

Neni 14.

B. Heqja e shtetësisë

Shtetësija shqiptare munt t'u hiqet pjestarëve të kombësisë të popujve shtetet e të cilëve kanë qënë në lufte me popullin shqiptar në rast se këto gjatë kësaj lufte ose edhe më përpara me qënimin e tyre kundrejt interesave të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë kanë shkelur detyrat e tyre si shtetas.

Shtetësija shqiptare munt t'i hiqet edhe çdo shtetasi të natyralizuar që ka fituar shtetësinë shqiptare me deklarata të rene, ose ka fshehur rreth me rëndësi rreth qëndrimit të tij, ose, brenda 5 vjetëve nga data e natyralizimit, dënohet për vepra kundra pushtetit dhe popullit.

Gjithashtu munt t'u hiqet shtetësija dhe shtetësive shqiptarë që ndodhen jashtë shtetit dhe shkaktojnë dëme në interesat kombëtare dhe shtetërore të Republikës Popullore të Shqipërisë ose anë vepruar në këtë mënyrë gjatë luftës Nacional-Lirimtare ose refuzojnë të kryejnë detyrat e tyre si shtetas.

Neni 15.

Shtetësija hiqet në rastet e paragrafit të parë të dytë të nenit 14, me vendim të Ministrisë së Punëve të Brëndëshme, kurse në rastin e paragrafit të tretë po të këtij neni me vendim gjyqi në rastet e parashikuara shprehimisht prej ligjës ose me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Neni 16.

Humbja e shtetësisë sipas paragrafit të parë të nenit 14 shtrihet dhe mbi bashkëshortin tjetër dhe mi fëmijët në rast se nuk provojnë se nuk kanë patur asnjë lidhje me atë që i është hequr shtetësija dhe se ata vetë kanë patur sjellje të mira, se janë të kombësisë shqiptare.

Humbja e shtetësisë, sipas paragrafit të dytë të nenit 14, shtrihet dhe mi fëmijët nënë 18 vjeç që kanë fituar shtetësinë shqiptare për shkak të natyralizimit të prindëve.

Neni 17.

C. Autorizimi për të lënë shtetësinë

Një person munt të autorizohet të lërë shtetësinë shqiptare kur ka plotësuar këto kondita:

- a) kur e ka kërkuar me lutje;
- b) kur ka mbushur moshën 18 vjeç;
- c) kur ka kryer të gjitha detyrimet e tij kundërshtetit;
- c) kur provon se është pranuar ose do të pranohet në një shtetësi të huaj.

Ministrija e Punëve të Brëndëshme, kur e gjen të arësyeshme mund të japi autorizimin e saj për lënjën e shtetësisë, por me konditë që i interesuari, brenda një kohë të caktuar, të provojë se ka fituar një shtetësi të huaj. Përkundrazi autorizimi nuk ka asnjë vlerë.

Gjithashtu autorizimi nuk ka asnjë vlerë në rast se ay që ka kërkuar të lërë shtetësinë shqiptare vazhdon të qëndrojë në Shqipëri dhe brenda një viti nuk fiton shtetësinë e huaj.

Kërkesa për të lënë shtetësinë shqiptare munt të paraqiten vetëm në kohë normale.

Shtetësi shqiptar i aftë për të kryer shërbimin ushtarak munt të lejohet që të lërë shtetësinë shqiptare përpara kryerjes së këtij shërbimi vetëm për arsye të jashtëzakonshme dhe gjithënjë me pëlqimin e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare.

Neni 18.

Mi pranimin ose refuzimin e kërkesës për të lënë shtetësinë shqiptare vendos Ministrija e Punëve të Brëndëshme.

Neni 19.

Fëmijët e mitur humbasin shtetësinë shqiptare kur e kërkon njëri nga prindët që ka autorizimin të lërë shtetësinë shqiptare po vetëm në rast kur me këtë autorizim që të dy prindët humbasin shtetësinë shqiptare, ose kur e humbet shtetësinë njëri nga prindët dhe tjetri nuk e ka patur më parë. Në qoftë se fëmija është më tepër se 14 vjeç, duhet të merret edhe pëlqimi i tij.

Në rast se fëmija e mitur nuk e fiton shtetësinë e re atëhere mban shtetësinë shqiptare gjersa nuk është shpërngulur definitivisht nga Shqipëria bashkë me prindët.

Neni 20.

C. Renoncimi

Shtetasi Shqiptar nga origjina ka të drejtë gjer në moshën 25 vjeç të renoncojë shtetësinë Shqiptare në qoftë se ka lindur jashtë, banon atje dhe provon se ka shtetësinë e shtetit ku ka lindur ose ku banon.

Shtetasi shqiptar që nuk është i kombësisë shqiptare ka të drejtë të renoncojë nga shtetësija shqiptare në rast se është shpërngulur nga Shqipëria dhe provon se ka fituar një shtetësi të huaj.

Përveç kësaj ai duhet të ketë plotësuar kushtet e nenit 17 të kësaj ligje numur 2 e 3.

Renoncimi sipas paragrafit të sipërm të këtij neni bëhet me anën e një deklarate që i paraqitet përfaqësisë diplomatike të Republikës Popullore të Shqipërisë jashtë shtetit ose Ministrisë së Punëve të Brëndëshme.

Përsa u përket fëmijëve të mitur zbatohen dispozitat e nenit 19 të kësaj ligje.

Kapitla e IV-t Rritim i Shtetësisë

Neni 21.

Kushdo që ka humbur shtetësinë shqiptare për shkak se, si fëmijë i mitur, ka ndjekur prindët e tij sipas neneve 19 e 20 të kësaj ligje, munt të fitojë përsëri shtetësinë shqiptare në rast se vendoset vazhdimisht në Shqipëri dhe paraqet për këtë një deklaratë të veçantë brenda 7 vjetëve pasi të ketë mbushur moshën 18 vjeç.

Kapitina e V-të
Dispozita të Përbashkëta

Neni 22.

Të gjithë personat, me kombësi shqiptare, që kanë lindur ose janë edukuar në Shqipëri prezumohen se janë shtetas shqiptarë gjersa të provohet se kanë një shtetësi të huaj, ose kanë humbur shtetësinë shqiptare, ose kanë kërkuar një shtetësi të huaj.

Ai që ka përfitur nga prezumimi i sipërmë dhe në bazë të këtij prezumimi u konsiderua si shtetas shqiptar nuk munt të invokojë më vonë një shtetësi të huaj.

Neni 23.

Fitimi i shtetësis shqiptare me naturalizim, humbja e saj për shkak mungese (absence), heqja e saj dhe lejimi për të lënë atë shpallen në "Gazetën Zyrtare".

Kapitina e VI-të

Dispozita tranzitore dhe të fundit

Neni 24.

Konsiderohen shtetas shqiptarë të gjithë ata që kanë fituar shtetësinë shqiptare gjër në hyrjen në fuqi të kësaj ligje në bazë të dispozitave të më parëshme.

Neni 25.

Shtetësit e akorduara pas 7 Prillit 1939 e gjër më 29 Nëntor 1944 do të shqyrtohen nga Ministrija e Punëve të Brendëshme e cila është kompetente të vendosë njohjen ose jo të këtyre shtetësive.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për femrat që për shkak të martesës së tyre me shtetas shqiptar, kanë fituar shtetësinë shqiptare sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 26.

Të gjithë personat me kombësi shqiptare që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 2 Dhjetorit të vitit 1945 konsiderohen që nga ajo datë shtetas shqiptarë pa patur të drejtë të pretendojë shtetësinë e huaj që munt të kenë patur më parë.

Neni 27.

Munt të fitojnë shtetësinë shqiptare me naturalizim shtetasit e huaj që kanë marrë pjesë aktive në luftën Nacional Çlirimtare të popullit shqiptar.

Në këtë rast shtetasit e huaj përjashtohen nga detyrimi që të plotësojnë konditat e nenit 7 të kësaj ligje pikat 2, 3 e 4.

Gjithashtu munt të përfitojnë nga dispozitat e paragrafit të sipërmë të këtij neni femijt e të huajve që kanë marrë pjesë në luftën Nacional Çlirimtare dhe janë vrerë ose kanë vdekur.

Neni 28.

Afati i parashikuar prej nenit 13 të kësaj ligje fillon të ecë që nga data e hymjes në fuqi të kësaj ligje.

Neni 29.

Autorizohet Ministri i Punëve të Brendëshme të nxjerrë rregullore dhe të vërë norma me hollësi në lidhje me zbatimin e kësaj ligje.

Neni 30.

Të gjitha dispozitat e më parshme mi shtetësi, në abrogohen.

Neni 31.

Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare".

Tiranë, më 16 Dhjetor 1946.

Presidenti i Kuvendit Popullor
të Republikës Popullore të Shqipërisë
Sekretari: **Presidenti:**
Sami Baholli d. v. Dr. Omer Nishani d. v.

KOMITETI EKZEKUTIV I N PREF. DEVOLL

V E N D I M

Nr. 87 19 11-46

Mbi sekuestrimin e pasunisë të tundëshme të sabotatorit të pushtetit dhe armik i popullit Demir Beqirit nga katundi Trestenik i Rethit të kësaj Nën-prefekturë.

Në themel të nenit 2, të ligjës nr. 40 dt. 14-I. 45, Komiteti Ekzekutiv i N Prefekturës Devollit urdhnon sekuestrimin e pasunisë së tundëshme të sabotatorit të pushtetit dhe armik i popullit, Demir Beqirit, përvec asaj që është përshkruar në vendimin nr. 87 dt. 5-4-46, Pronia dynym 41 dhe një pjesë të Mullirit që ndodhë buzë kufirit grek që që sot nuk punon.

Komiteti Ekzekutiv

V E N D I M

Nr. 99 datë 19 XI 46

Mbi sekuestrimin e pasunisë të pa tundëshme të kriminelit të luftës dhe armik i popullit, Hymer Hasanit nga katundi Bozhigrad i rethit të kësaj N Prefekturë.

Në themel të nenit 2, të ligjës nr. 40 dt. 14-I. 45 Komiteti Ekzekutiv i N-Prefekturës Devollit, urdhnon sekuestrimin e 36 dynymëve pronja dhe 808 m. 2,10 dynymëvet e gjysëm korije, që ndodhet në kufitë të katundit Bozhigrad, si dhe 1/2 pjesë të një gur mulliri që ndodhet afër katundit Bozhigrad, përveç pasunisë tjetër që është përshkruar në vendimin nr. 99 dt. 5-4-46.

Komiteti Ekzekutiv.

V E N D I M

Nr. 185 datë 10-9-1946

Në themel të nenit 2, të Ligjës nr. 40 dt. 14 I. 1945, dhe të neneve 3 të ligjës nr. 135, dt. 15 Nëntor 1945, Komiteti Ekzekutiv i N. Prefekturës Devollit urdhnon sekuestrimin e pasunisë të tundëshme dhe të pa tundëshme të aratisurit Ali Sabritut nga katundi Stropan, si vijon.

Pasuni të pa tundëshme 1 shtëpi me dy kate me gjithë vjeksat, dhe 22,1/2 dynym pronja dhe kopshte të ndodhuna me kufi të katundeve, Stropan Baban dhe Eçmenik.

Pasuni e tundëshme: 2 qillimka, 2 sikhade, 2 jorgana, 1 kusl e madhe, 7 pjata, 1 but.

Komiteti Ekzekutiv.